

HUAZIMET NË LIGJËRIMIN E SPECIALIZUAR (STILI JURIDIKO-ADMINISTRATIV)

Mirela PAPA

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës Itالية, Tiranë
SHQIPËRI

E-mail: papamirela@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Në gjuhën letrare shqipe stilet rigrupohen në dy pjesë përbërëse: *ligjërimin e përgjithshëm* dhe *ligjërimin e specializuar*. Një ndër karakteristikat e terminologjisë përbërëse të ligjërimin të specializuar është përdorimi i huazimeve. Kemi parë llojet e huazimeve në ligjërimin e specializuar (tek stili juridiko-administrativ) si edhe disa dukuri të veçanta që vihen re tek huazimet në gjuhën juridike duke arritur në konkluzionin se huazimet në ligjërimin e specializuar janë të domosdoshme sidomos ato huazime që të futura në gjuhën shqipe bashkë me sendin apo fenomenin që shenjojnë bëjnë tashmë pjesë në terminologjinë e fushës përkatëse. Por kemi tërhequr vëmendjen për përdorimin e të *ashtuquajturave huazime*, që në fakt nuk janë gjë tjetër veçse një shpërfillje e termave ekzistuese në gjuhën shqipe dhe një mizërim i panevojshëm i fjalëve të huaja në tekstet e specialitetit.

Fjalë kyçe: huazime, stilistika funksionale, ligjërimin i specializuar, stili juridiko-administrativ.

HYRJE

Baza e këtij punimi janë tekstet mësimore. Ato përbëjnë nivelin tekniko-shkencor të ligjërimin të specializuar. Por, ndonëse janë të shkruara me shkronja shqipe nuk tingëllojnë aspak shqip

duke mos i ndihmuar studentët në formimin e një vetëdijeje gjuhësore. Këto janë edhe arsytet e këtij studimi. Objektivat janë të qarta: të shikohet ligjërimin i specializuar në krahasim me ligjërimin e përgjithshëm dhe më në veçanti huazimet në stilin juridiko-administrativ. Rëndësia që ky punim ka është se, përveçse mundohet të japë një tipologji të përdorimit të huazimeve në ligjërimin e specializuar, kërkon të tërheqë vëmendjen mbi përdorimin e tepërt dhe të gabuar të huazimeve duke ngritur domosdoshmërinë e një redaktimi gjuhësor të teksteve të specialitetit me qëllim përkujdesjen ndaj gjuhës sonë amtare.

Në varësi të aftësisë që kanë mjetet shprehëse në gjuhën shqipe mund të bëjmë një ndarje të gjuhës në dy pjesë përbërëse kryesore: **a) ligjërimin e përgjithshëm**, [4] (ku mjetet shprehëse të gjuhës karakterizohen nga ngjyresat stilistikore) [6] i cili ka në bazë stilin e letërsisë artistike dhe pjesërisht stilin politiko-shoqëror me karakter ndikues (politik) dhe sugjestiv (fetar) **b) ligjërimin e specializuar**, (ku mjetet shprehëse janë të zhveshura nga ngjyresat stilistikore) i cili bashkon dy stilet me karakter të mirëfilltë special, stilin shkencor-teknik dhe atë juridik-administrativ, si dhe pjesët me përdorim të mjeteve gjuhësore, të zhveshura nga efektet ndikuese d.m.th. stilin politiko-shoqëror dhe sugjestiv (fetar).

Çfarë është *ligjërimi i specializuar* apo ato të quajtura ndryshe “*gjuhët sektoriale*” apo “*gjuhët e specialitetit*” apo “*nënkodet e gjuhës*”? (Në shumë nga literaturat e huaja lidhur me këtë problem dalin edhe termat *gjuhë e përgjithshme* dhe *gjuhë speciale* (e specialitetit) ose *gjuhë për qëllime speciale*. Termi *ligjërim* rezulton me vend kur i referohet jo vetëm kodit gjuhësor, por edhe llojeve të tjera të komunikimit; p. sh. në kimi i njëjti lloj informacioni mund të përcillet përmes kodit gjuhësor apo një formule.) [4]

Ligjërimi i specializuar, i cili në një kuptim më të gjerë mund të shihet si objekt më vete jashtë stilistikës gjuhësore në kundërvënie me ligjërimin e përgjithshëm, është një variacion i gjuhës i karakterizuar nga këto veçanësi:

- reflekton përgjithësisht një dije të veçantë, që ndahet mes një pakice ekspertësh, dhe ka si synim të favorizojë dhe lehtësojë komunikimin në këtë grup;

- përdor karakteristika të gjuhës, duke i ndërthurur këto karakteristika për sa i përket leksikut dhe formimit të fjalëve;

- ka prirjen, në ndryshim nga ligjërimi i përgjithshëm – polisemantik nga natyra – të vendosë një raport të saktë dhe të qëndrueshëm mes fjalëve dhe gjërave.

Cilat janë këto *ligjërime të specializuara*?

Ndërsa në *stilin juridik-administrativ* bën pjesë siç mund të kuptohet fare lehtë gjuha juridike dhe ajo që përdoret në administratën shtetërore, në *stilin shkencor-teknik* mund të dallojmë një sërë ligjërimesh apo gjuhësh: gjuhën e mjekësisë, të fizikës, të kimisë, të ekonomisë, të sociologjisë, të matematikës etj.

Për të formuar fjalorin tekniko-shkencor të një disipline janë ndjekur dhe ndiqen tri rrugë.

Huazimet (gjuhësore): Kur gjuha përdor dhe përvetëson një karakteristikë gjuhësore që ekzistonte më parë në një gjuhë tjetër. Ky proces bashkë me karakteristikën gjuhësore që përvetësohet në këtë mënyrë quhen me të njëjtin term: **huazime** [3].

Fjalëformimi: disa parashtesa dhe prapashtesa kanë patur një përhapje të gjerë në fjalorët tekniko-shkencor: p. sh. në mjekësi emrat që lidhen me sëmundjet përdorin shpesh prapashtesat

e mëposhtme me origjinë greke:

- ozë = afekcion kronik: artrozë, dermatozë, cerozë

- it = inflamacion akut: artrit, dermatit, nevrin.

Lëvizja semantike (12): i jepet një kuptim i ri dhe i veçantë fjalëve të cilat ekzistojnë tashmë në ligjërimin e përgjithshëm. P.sh. fjalë si bazë, fushë etj (vetëm ose të shoqëruara nga një element i caktuar) marrin vlera të tyre në disiplina të ndryshme: fushë aviacioni, fushë magnetike etj.

Ligjërimi i specializuar ka disa nivele të aktualizimit të tij (niveli thjeshtligjërimit; niveli bisedor; niveli shkencor-popullor; niveli shkencor i mirëfilltë; niveli shkencor-teknik; niveli teknik i mirëfilltë). Jemi ndalur tek niveli tekniko-shkencor (ku futet gjuha e teksteve mësimore) dhe do të shikojmë tipologjinë e huazimeve në këtë nivel për **gjuhën juridike**.

LLOJET E HUAZIMEVE NË FUSHËN E SË DREJTËS

Në fushën e së drejtës mbizotërojnë huazimet nga latinishtja. Kjo sepse e drejta romake është ndër të drejtat që mbretëruan në antikitet dhe që ka influencuar më shumë në evolucionin e mendimit dhe të koncepteve juridike të epokave të ndryshme historike. Gjurmët e saj i gjejmë ende “të padëmtuara” në rendin juridik modern të vendeve latino-gjermanike, por kjo nuk do të thotë se ato mungojnë në sistemet e tjera të së drejtës [7]. Kjo influencë pa dyshim është ndier edhe në të drejtën në Shqipëri. Marrim si shembull *Kodin Civil* shqiptar të vitit 1929 i cili u hartua nën ndikimin e drejtpërdrejtë të modeleve romaniste të së drejtës private [9]. Legjislacioni ynë i mbas viteve ‘90 kategorizohet në sistemet e së drejtës në tranzicion, të influencuara nga sisteme të ndryshme. Nuk mungojnë pra edhe huazime nga gjuhë të tjera.

Huazimet më të zakonshme dhe më të përhapura në gjuhën shqipe janë huazimet e fjalëve bashkë me sendet a me konceptet e reja. Në qoftë se për ne bëhet i njohur një objekt ose koncept i panjohur, atëherë në leksik hyn edhe emërtimi për të, sipas gjuhës nga e cila vjen [12]. Këtu nuk bëjnë përjashtim edhe huazimet në gjuhën juridike.

Do të dallojmë këtu:

1 Huazime të painteguara apo huazime të

plota (3), kur fjalët merren në formën e tyre origjinale:

ad substantiam = për vlefshmëri

ad probationem = për provueshmëri

causae cognitio = shkak i fshehur

mortis causa = për shkak të vdekjes

condicio iuris = kushti ligjor

actus legitimi = veprime juridike të pastra

lex rei sitae = padia ngrihet në gjykatën e vendit ku ndodhet sendi

ex officio = zyrtarisht

communis opinio doctorum = opinioni i përbashkët i dijetarëve

erga omnen = vlerë e përgjithshme

contra constitutionem = në kundërshtim me kushtetutën

2 Huazime të integruara apo huazime strukturore [3], kur fjalët e huazuara i nënshtrohen rregullave të fonetikës dhe të morfologjisë së gjuhës shqipe. Ndryshojnë disa fonema, shtohet ndonjë mbaresë dhe hyjnë kështu në kategoritë e ndryshme leksiko-gramatikore të gjuhës shqipe:

prokurë, dispozitë, kirograf, testament olograf, servituti, uzufukti, legu, subsidar, veprim nul, derogimi, rekuizimi, uzufuktari, deponoj, kasus, ekstrakte, reskripte, rekurs, ratifikim, revokim, sheriami, nihilizëm juridik, posedim, amendim, ekstradim, sanksione, integritet, diskriminim, mandat, prezumim etj.

Një lloj i veçantë i huazimeve janë edhe **kalket**. Dallohen dy lloje kryesore:

1. Kalket-përkthim: kemi të bëjmë me fjalë të formuara me brumin e shqipes, në to i huaj është vetëm ndërtimi i fjalës apo i sintagmës që shënon një koncept të vetëm në fushën e studimit [12]: *parashkrimi, veset e vullnetit, vëllimi i tagrave, gabimi-oes, frutat civile, i kryer për faqe, mashtrim ndërhyrës, kompetenca lëndore, burime-akte, burime-fakte, kolegjet e bashkuara, Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit, votim i zhdrejtë, votim dyshkallësh, rezerva absolute e ligjit, rezerva relative e ligjit, rezerva e juridiksionit, liritë negative, liritë pozitive, votë plurale, mashtrimi i keq, e keqe e konsiderueshme, kusht pezullues, kusht i munguar, kusht vullnetar etj.*

2. Kalket semantike: Krijohen kur një fjalë e gjuhës shqipe merr një kuptim të ri nga një fjalë

e huaj; ky fenomen verifikohet kur dy fjalët kanë të përbashkët një kuptim ose një ngjashmëri formale. Zbatohet dukuria e lëvizjes kuptimore, e njohur tashmë në semantikën leksikore dhe, me ngushtim kuptimi, fjalë të përdorimit të përgjithshëm në ndikimin e kuptimit në gjuhën e huaj kalojnë në një fushë më të ngushtë përdorimi, që është ajo e gjuhës së specialitetit:

barra = 1. Një tog sendesh që i ngarkohen një kafshe ... 6. (drejt.) Detyrim që kufizon të drejtat e pronarit të një pasurie për shkak të të drejtave të një pronari tjetër ose të shoqërisë.

institucion = 1. Organizëm shtetëror a shoqëror, që zhvillon veprimtarinë e vet në një fushë të caktuar të ekonomisë, të shkencës, të kulturës etj. 2. (drejt) Mënyrë jetese ose sjelljeje që është rregulluar sipas ligjeve, normave e zakoneve të vendosura brez pas brezi në një shoqëri.

institut = 1. Shkollë e lartë që përgatit specialistë për një a disa degë të ekonomisë e të kulturës, të shkencës e të teknikës; qendër për kërkim e studime shkencore në një fushë të caktuar... 2. (drejt.) institucion.

Dukuri të veçanta që vihen re tek huazimet në gjuhën juridike:

Së pari, vëmë re dukurinë e **luhatjes** së huazimeve përpara se të marrin një formë të fiksuar përfundimtare.

të anulueshme = të anulueshme

fallco = fals = e rremë

legatari = legatori

magistrati = magistrati

restitucioni = restituimi

iurisconsultët = iuriskonsultët

gilde = gjilde

Në disa raste krijohet **homonimi**:

fakultete₁ = (sh.) Pjesë e një shkolle të lartë, që përfshin një degë ose disa degë të afërta të dijes; ndërtesa e kësaj pjese të shkollës së lartë.

fakultete₂ = (drejt.) shfaqje e së drejtës subjektive

rezervë₁ = 1. Sasi ushqimesh, mallrash, lëndësh që vihet mënjandë për ta përdorur kur të dalë nevoja.

rezervë₂ = (drejt.) Pjesë e trashëgimisë e rezervuar me ligj trashëgimtarëve të ligjshëm.

Vihet re **bashkëpërdorimi** i fjalës së huazuar dhe fjalës gjegjëse në gjuhën shqipe. Kjo pavarësisht se në gjuhën juridike në bazë të parimeve dhe rregullave për hartimin e akteve normative kërkohet që të shmangët përdorimi i termave të huaj, përveç rastit kur kanë hyrë në përdorimin e përditshëm të gjuhës shqipe dhe nuk kanë fjalë të tjera korresponduese në shqip [2]:

dispozitë e bardhë = dispozitë *blankete*
 mashtrim *ndërhyrës* = mashtrim *aksidental*
modusi = nderimi, *pesha, barra*
 të drejta *pasurore* = të drejta *patrimoniale*
 padi *krijuese* = padi *konstitutive*

Vihet re gjithashtu një fenomen që rrok të gjithë fushën e botimeve në këto 20 vitet e fundit. Nën ndikimin e gjuhëve të huaja dhe si pasojë edhe e mungesës së redaktimit gjuhësor në mjaft tekste juridike bëhen përkthime jo të sakta dhe përdoren në shqipe disa fjalë, *të ashtuquajtura huazime, apo huazime subjektive, ose huazime të panevojshme (huazime luks)* [3] por që në fakt janë një përkthim i keq në gjuhën shqipe i fjalëve të huaja. Madje edhe në ato raste kur përdoret termi i saktë i gjuhës sonë në kllapa futet edhe termi i huaj a thua se për hartuesit e librave fjala e gjuhës amtare nuk tingëllon, sikur nuk e thotë atë që kërkohet, prandaj nxitojnë ta zëvendësojnë atë me fjalën e huaj, me bindjen e tyre se fjala e huaj ka diçka të veçantë dhe i jep më mirë konceptet: vullnet *i vesuar* = i parregullt, i pavlefshëm (nga gjuha italiane *viziato* ndërkohë që *i vesuar* në shqipe do të thotë *i lagur nga vesa*). Edhe duke e konsideruar si neologjizëm nuk duhet të përdorej sepse: 1. *Teknika legjislativë* këshillon shmangien e përdorimit të neologjizmave, të cilët nuk janë bërë ende të përdorshëm në gjuhën shqipe (2). 2. *i vesuar* në shqipe është mbiemër që rrjedh nga emri vesë dhe jo ves:

“prokura bëhet gjithmonë *me shkresë*” = me shkrim (*me shkresë* është shprehje e vjetëruar që do të thotë shkrim e këndim, shkollë. Me shkrim do të thotë paraqitja e ligjërimit të folur me anë shenjash të posaçme grafike:

veprime juridike *kauzale* = shkakësore
preambula = hyrja, parathënia
diskrecioni = gjykimi, maturia

invokuar = i thirrur
abrogimi = shfuqizimi
testatori = trashëgimlënësi
kondicionimi = kushtëzimi
konvalidoj = vleftësoj
parakonditë = parakusht
 në formën e *ometimit* = në formën e mospërbushjes, shmangies etj.
delikti = krimi
delinkuenti = krimineli
legjislatori = ligjvënësi, hartuesi i ligjit, ligjbërësi
legal = ligjor
suprimoj = heq
konfirmoj = vërtetoj
implementim = zbatim
ekuivok = dykuptimësi
substancial = thelbësor

PËRFUNDIME

Në mbyllje mund të themi se qëllimi i këtij punimi ishte të hidhte një vështrim të përgjithshëm mbi ligjërimitin e specializuar dhe përdorimin e huazimeve në këtë lloj ligjërimit duke u ndalur në huazimet në gjuhën juridike.

Si përfundim mund të pohojmë se huazimet në ligjërimitin e specializuar janë të domosdoshme (siç e pamë mënyra e parë e formimit të terminologjisë në gjuhën e specializuar është pikërisht huazimi) sidomos po të kemi parasysh ato huazime të cilat të hyra në gjuhën shqipe së bashku me sendin apo fenomenin që shenjojnë bëjnë tashmë pjesë në terminologjinë e fushës përkatëse dhe për të cilat nuk kemi ndonjë alternativë tjetër, përveçse t'i pranojmë ashtu siç bëjnë edhe gjuhët e tjera.

Por ajo për të cilën tërheqim vëmendjen edhe një herë është përdorimi i të **ashtuquajturave huazime**, që në fakt nuk janë gjë tjetër veçse mungesë kompetence gjuhësore nga ana e hartuesve të teksteve shkollore të këtyre fushave. Për këtë qëllim do të sugjerohet që tekstet juridike të kenë patjetër një redaktor gjuhësor, i cili mungon në pjesën dërrmuese të tyre. Kjo me qëllim që të respektohet roli i rëndësishëm që luan shkolla, jo vetëm për formimin e vetëdijes gjuhësore, por edhe për politikën gjuhësore që ajo ndjek për përdorimin dhe përkujdesjen ndaj gjuhës.

BIBLIOGRAFIA

- ANASTASI A., (2004) *E drejta kushtetuese*, Pegi, Tiranë.
- BERBERI S., (2007) *Teknika Legjislative*, Botim i Qendrës së Studimeve parlamentar, Tiranë, fq. 74-75.
- DARDANO M., TRIFONE, P. (1997) *La nuova grammatica della lingua italiana*, Zanichelli, Bologna, fq. 566-567.
- DURO A. (1997) *Terminologjia në ligjërimin e specializuar*, Studime filologjike, Nr. 1-4, fq. 71-78.
- INSTITUTI i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980.
- LLOSHI Xh. (2001) *Stilistika e gjuhës shqipe*, Sh.b.l.u. Tiranë fq. 147-283.
- MANDRO A. (2006) *E drejta romake*, Tiranë, fq. 27.
- NUNI A. (2004) *Leksione të së drejtës civile*, Tiranë.
- NUNIA. (2006) *Hyrje në të drejtën civile*, Botimet Morava, Tiranë, fq. 30.
- NUNI A. HASNEZIRI L. (2007) *Leksione të së drejtës së pronësisë*, Tiranë.
- NUNI A., HASNEZIRI L. (2007) *Leksione të së drejtës së trashëgimisë*, Tiranë.
- THOMAI J. (2002) *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Sh.b.l.u. Tiranë, fq. 88, 229-230.
- ZENELI B., DANAJ S. *Shkrim akademik (Cikël leksionesh dhe përmbledhje artikujsh)*, Ufo Press, Tiranë, fq. 66-80.